

VENDIM
Nr. 744, datë 12.12.2025

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË
NËPUNËSVE DHE TË PUNONJËSVE TË DREJTORISË SË SHËRBIMEVE
QEVERITARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 10, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e strukturës së pagës mujore për nëpunësit dhe punonjësit e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare.

2. Për pozicionet e nëpunësve nga “specialist” deri në “titullar institucioni”, kategoritë e klasave, shtesa e nivelit të kualifikimit që shpërblen nivelin arsimor të kërkuar për pozicionin përkatës të punës, si dhe shtesa për vjetërsi në punë, në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, janë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Elementet përbërëse të pagës bruto mujore (paga për pozicion, shtesa për vjetërsi në punë dhe shtesa e nivelit të kualifikimit) për secilën klasë të përcaktuar në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si dhe vlerat për secilin element janë të njëjta me ato të miratuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në institucionet e administratës shtetërore.

4. Përfitojnë shtesë për kushte pune nëpunësit, si më poshtë vijon:

a) titullari i institucionit në masën 150 000 lekë/muaj;

b) drejtori në Drejtorinë e Menaxhimit të Godinave Shtetërore, drejtori në Drejtorinë e Udhëtimeve dhe Akomodimit dhe drejtori në Drejtorinë e Eventeve dhe Trajtimit të Personaliteteve, në masën 40 000 lekë/muaj;

c) shefi i Sektorit të Udhëtimeve, shefi i Sektorit të Akomodimeve, shefi i Sektorit të Projektimit dhe Planifikimit të Hapësirave, shefi i Sektorit të Administrimit dhe Mirëmbajtjes, shefi i Sektorit të Mobilimit dhe Infrastrukturës së Brendshme, shefi i Sektorit të Godinave Qeveritare, shefi i Sektorit të Ideimit dhe Organizimit, shefi i Sektorit të Zbatimit dhe shefi i Sektorit të Trajtimit të Personaliteteve, në masën 35 000 lekë/muaj;

ç) shefi i Sektorit të Shërbimeve të Përgjithshme në Kryeministri në masën 50 000 lekë/muaj;

d) specialisti i udhëtimit, specialisti i akomodimit, specialisti inxhinier, specialisti arkitekt “Interior design”, specialisti i restaurimit, specialisti i logjistikës/terenit, specialisti i organizimit, specialisti i shërbimit në Sektorin e Trajtimit të Personaliteteve dhe specialisti arkitekt projektues, në masën 30 000 lekë/muaj;

dh) specialisti i arkivit dhe protokollit në masën 5 000 lekë/muaj;

e) specialisti në sektorin e godinave qeveritare në masën 25 000 lekë/muaj.

5. Klasat e pagës, shtesat për vjetërsi në punë, si dhe shtesat për kushte pune të punonjësve mbështetës në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare janë sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Vlera e pagës bazë për klasë dhe mënyra e llogaritjes së vjetërsisë për secilën klasë të përcaktuar në lidhjen nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, janë të njëjta me ato të miratuara

në vendimin e Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve mbështetës në institucionet e administratës publike.

7. Vendimi nr. 365, datë 16.6.2023, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve dhe punonjësve të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare”, i ndryshuar, shfuqizohet.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2026 për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LIDHJA NR. 1			
STRUKTURA E PAGËS SË PUNONJËSVE TË DREJTORISË SË SHËRBIMIT QEVERTAR			
Funksioni	Kategoria/ Klasa	Paga e grupit (lekë)	Shtesa për vjetërsi (sipas mënyrës së llogaritjes në vendimin e Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në institucionet e administratës shtetërore)
1	2	3	4
Titullar i Institucionit	I-2	1	
Shef Kabineti	I-5	1	
Këshilltar	II-2	1	
Drejtor,	II-2	1	
Shef Sektori	III-1	1	
Specialist	IV-1	1 ose 2	
Asistent i Titullarit; Redaktor Ligjor; Specialist në Kryeministri;	IV-1	1 ose 2	
Specialist; Specialist Arkive/ Protokolli; Sekretar i Këshillit Drejtues; Sekretar për Ish-Presidentët	IV-2	1 ose 2 ose 3	

LIDHJA NR. 2			
STRUKTURA E PAGËS SË PUNONJËSVE TË DREJTORISË SË SHËRBIMIT QEVERTAR			
Funksioni	Kategoria/klasa	Shtesa për vjetërsi (sipas mënyrës së llogaritjes në vendimin e Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve mbështetës në institucionet e administratës publike)	Shtesa për kushte pune (lekë)
Kryekuzhinier I	IX		135,000
Kryekuzhinier II	IX		75,000
Kryepastiçier;	IX		50,000
Kryekamerier;	IX		45,000
Administrues Vila 4, Vila 30,	IX		70,000
Administrues Vila 5, Pallati Kongreseve	IX		50,000
Administrues vila/qendrash	IX		35,000

Kuzhinier vila qeveritare; kuzhinier në rezidencat e krerëve të lartë të shtetit; ndihmëspastiçier.	VIII		35,000
Ndihmës kuzhinier	VIII		45,000
Banakier;	VIII		42,500
Kryepunëtor Rezidenca Qeveritare;	VIII		35,000
Magazininier i Magazinës Industriale; Transportit; Ushqimore; Pallati i Brigadave.	VIII		30,000
Magazininier i magazinës dytësore Pallati i Kongreseve; rekupero; Dytësore Durrës; Teknik elektrikist; teknik mirëmbajtjeje; teknik ndërtimi; teknik bojaxhi; teknik sisteme ngrohje-ftohje; teknik marangoz; teknik hidraulik	VII		30,000
Teknik Elektricitist në KM/Teknik Hidraulik në KM /Teknik mirëmbajtjeje në KM, Punëtor në rezidenca qeveritare;	VII		35,000
Kamerier;	VII		40,000
Shofer/korrier; shofer në Kryeministri;	VII		45,000
Teknik/kameraman, teknik/fotograf në Kryeministri	VII		80,000
Teknik korrier në Kryeministri	VII		40,000
Shofer; shofer/korrier	VI		40,000
Punëtorë mirëmbajtjeje; punëtor gjelbërimi; roje magazina industriale; roje.	IV		20,000
Punëtor pastrimi; punëtor pastrimi në Kryeministri; punëtor gjelbërimi në Kryeministri.	IV		35,000